



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 339/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të personave të pa autorizuar në Qendrën e Votimit QV, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë.

**Arsyetim**

Me datë 10.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK ku pretendohet se me datën 08.06.2014 rreth orës 11:30, është konstatuar shkelje e nenit 33 dhe 36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me ç'rast dëshmitari Hamdi Hasani me rastin e daljes për të votuar në Qendrën e Votimit 1122B (shkolla fillore Jusuf Rexha - Kushtovë e Bobit) ka vërejtur se disa aktivistë të subjektit politik LDK, respektivisht nënkryetari i nëndegës – Koshtovë, Behram Hasani i shoqëruar nga Ferki Feka dhe të tjerë, kan shpërndarë material propagandistik, gjegjësisht, vizitkartela dhe fletëpalosje të subjektit politik LDK, në hyrje të shkollës (QV) në fjalë, duke shqetësuar dhe shkaktuar presion, ndikim të votuesit që të votohet subjekti dhe kandidatët e LDK-së.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës me datën 11.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj saj nga ana e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankesë deri më datë 11.06.2014 në ora 18:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ku konsiderojnë se është e pabazuar nga fakti se pretendimet për shkeljet ligjore nuk janë të dëshmuara me prova materiale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Nga pretendimet ankimore të cekura, nuk mund të vërtetohet ajo për të cilin deklaroi pala ankuese në ankesën e saj, pasi që nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi. Prandaj një pretendim i tillë ankimor është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar dhe se për këtë arsye ankesa në fjalë u vlerësua si e pa bazuar sipas nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 339/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja -prek një të drejtë themelore.*